



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER REZARTA B. KOÇI
ADRESA NR.9, BLV"ZOGU I PARE",
NR.97, NR.1, NR.1
TEL: 672041909

VERTETIM NENSHKRIMI

(STATUTI)

Nr. repertori: 6325

Tirane më 02/10/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2020053080406812046



STATUT
I
SHOQËRISË "ALBANET-AL" sh.p.k
KREU I
KRIJIMI, FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI SELIA, DHE
KOHEZGJATJA E SHOQERISE.

Shoqëria me përgjegjësi te kufizuar "ALBANET-AL" sh.p.k me seli :
rruga e Dëshmorëve", ish-pallati i "Pionerëve", Ndertesa nr.5, Hyrja Nr.5, Ersekë-Kolonjë, Kutia
Postare 7401, është krijuar sipas akt themelimit qe i bashkëlidhet ky statut i përpiluar dhe nënshkruar nga :

SHOQERIA "ALBASCAN" SHPK, me seli ne Tirane, Rruga Barrikada, Hyrja 1, perballe
gjimnazit "Sami Frasheri", Zona kadastrale 8360, Nr pasurie 5/351, regjistruar si person juridik
prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me Nr. NIPT L71416010E, perfaqesuar nga
Administratori **Z.Elton Jorgjis**, i biri i Thoma, i datelindjes 07.08.1980, lindur ne Sovjan dhe
banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor, shtetas shqiptarë, madhor, me zotesi te plote juridike
per te vepruar, identifikuar nepermjet Leternjoftimit me nr.Personal **I00807033U**, **e cila ne baze**
të vendimit të ortakeve Nr. 01, datë **02/10/2020**, **ka marr vendim dhe ka**
autorizuar administratorin e saj, të hartojë dhe nënshkruaj këtë statut për themelimin e
shoqërisë "ALBANET-AL" sh.p.k, mbështetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Për tregtarët
dhe shoqëritë tregtare", Ligj Nr.131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", Kodin Doganor,
Fiskal e Tatimor, si me poshtë:

Neni 1

Krijimi

Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit te saj.

Emërtimi i shoqërisë është "ALBANET-AL" sh.p.k

Kjo shoqëri është person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar (me poshtë e
quajtur "Shoqëria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria "ALBANET-AL" sh.p.k, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga "ortakët e
shoqërisë", të cilët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht
humbjet e shoqërisë deri ne pjesën e pashlyer te kontributeve te nënshkruara. Kontributet e
ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar te shoqërisë.Parashikime te tilla vlejne vetem dhe
vetem per detyrimet qe rrjedhin ne emer te shoqerise nga ortakët ne periudhen pas nxjerrjes se
NIPT-it, nga QKR. Mbas nxjerrjes se NIPT-it cdo lloj detyrimi qe rrjedh ne emer dhe per
llogari te shoqerise do te jete i pagueshem nga shoqeria nga kapitali i saj, duke qene se ka
kapitalin e saj.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë ne rruga e Dëshmorëve", ish-pallati i "Pionerëve", Ndertesa nr.5, Hyrja
Nr.5, Ersekë-Kolonjë, Kutia Postare 7401.

Shoqëria mund te ndryshoje selinë e tij, te hape zyra përfaqësie, dege, te krijojë filiale, si
brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim te asamblesë se ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë për objekt të veprimtarisë të saj:

Import - eksport, tregtim me shumice e pakice të mallrave të ndryshme industriale, materiale ndertimi, paisje elektronike, audio - vizive, elektrike, informatike, elektroshtepiake, konfeksione, artikuj të ndryshëm mobilierie, Hapje bar - kafe dhe restorante , dyer, dritare, paisje zyre, kanceleri, paisje ventilimi dhe kondicionimi. Konsulenca, ndermjetsime në fushat e ndryshme të tregtis. Administrim objektësh. Shit blerje Kontenti Televiziv, shitblerje kapaciteti interneti. Ndertimi dhe perpunimi i qendrave Data Base. Produksione Televizive me ze dhe figure. Evente Radio Televizive Live. Transmetimeve dhe Ritransmetimeve Audio, Video dhe Data. Ndertim i Rrjeteve Fizike dhe Virtuale dhe të shërbimeve IP/telefoni (Internet Protocol) .Krijimi Platformave audio video ofruese, kanaleve televizive dhe transmetimi nepermjet satelitet, internetit, sistemeve të frekuencave toksore, ajrore, kabllore Punime germimi në toke.Ndertime civile dhe industriale. Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasada. Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha , tramvai, metro, pista aeroportuale. Punime nëntokesore, ura e vepra arti. Diga dhe tunele hidroteknike. Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje. Ndertime detare dhe punime thellimi në ujë. Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime. Ndertimi I mplantëve për prodhimin e energjisë elektrike.Ndertime për n/stacionet, kabinat e transformatoreve, linja në TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. Punime të inxhinierisë së mjedisit. Distribucion, Shitje, Mirembajtje dhe Suport i produkteve për institucione të sigurojë se lartë. Të ideojë, planifikojë dhe zbatojë: Rrjete elektrike, Rrjete data, Sisteme Survejimi dhe Sigurie të të gjitha llojeve, Rrjete telefonike IP dhe analoge, Sisteme Fonia të llojeve të ndryshme, Data Center tepermasave të ndryshme duke përfshirë pajisjet Hardware dhe Softwaret e nevojshëm. Punime Civile të nevojshme për kryerjen e lidhjeve në fushat e mesiperme. Të ofrojë mirembajtje të përhershme. Shërbim Konsulencë, Keshillimi dhe Trajnimi për Sistemet informatike dhe çdo gjë tjetër të përmendur më sipër. Të ofrojë Shërbime lidhje Informatike online. Materiale të ndryshme kancelarie. Në funksion të qellimeve të mesiperme Shoqëria mund të hyjë në tregje dhe operacione të ndryshme, të zotërojë pasuri të luajtshme e të paluajtshme dhe/ose pjesëmarrje në shoqëri të tjera tregtare. Import-eksport të produkteve Rreze X, produkte të sigurojë se lartë. Mirembajtje dhe riparime të produkteve Rreze X, produkte të sigurojë se lartë.Për më tepër, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i cili nuk është i ndaluar nga legjislati në fuqi.Ortakët e Shoqërisë kanë të drejtë të marrin vendim për të shtuar objektin e veprimtarisë së shoqërisë ”

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore mbi 10 vjet.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë: **5.000.000 Leke** (pese milion lekë) e përbërë nga 1 (një) kuote dhe i përket ortakëve si më poshtë.



Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

Te gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar e shlyer krejtësisht.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/te paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e demit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Vendimi për ndryshimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

shitblerjes;

trashëgimisë;

d) dhurimit;

e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të behet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakeve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakeve, me të drejtën e parablerjes së ortakëve të tjerë.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

ndryshimet e statutit;

c) emërimin e shkarkimin e administratoreve;

ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar;

d) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;

dh) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecërisë së veprimtarisë; miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecërisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Të gjithë veprimet që kanë të bëjnë me shitjet - blerjet lidhjet e kontratave me të tretet të çdo lloji, me organet qendrore etj do të kryhen vetëm nga personi apo personat e autorizuar me vendim të asamblesë së ortakeve .

k) Kontratat e punës së punonjësve, paga e shpërblimi i tyre do të bëhen nga personi apo persona të autorizuar me vendim të asamblesë së ortakeve.

l) Ndarja e fitimit dhe shpërblimi midis ortakeve do të bëhet me vendim të asamblesë së ortakeve

m) Me vendim të asamblesë së ortakeve caktohen personi apo personat që do të përfaqësojnë shoqërinë përpara bankave të çdo niveli që operojnë në Republikën e Shqipërisë, në këtë vendim do të përcaktohet në mënyrë të detajuar kompetencat e personit apo personave që do të veprojnë në emër të shoqërisë me bankat. Edhe administratori i shoqërisë do të hapë 1 llogari apo kryejë veprime me bankat vetëm me autorizim të asamblesë së ortakeve të shoqërisë

Ortaku mund të përfaqësohet në asambleje të përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i trete.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakeve në asamblenë të përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



Neni 10

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postes elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblese. Kur "asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortaket janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 11

Kuorumi

Ne rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortaket me të drejte vote, që zotërojnë me shume se 30 për qind të kuotave.

Ne rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortaket që zotërojnë me shume se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo me vone se 30 dite, me të njëjtin rend dite.

Neni 12

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, miratimin e bilancit, kontrollin e llogarive, miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë, riorganizimin, bashkimin ose ndarjen e shoqërisë, shndërrimin në një formë tjetër, transferimin e kuotave, emërimin e eksperteve dhe likuidatorëve dhe prishjen e shoqërisë, zhvillon mbledhje të jashtëzakonshme, të cilat janë të vlefshme, kur në të janë të pranishëm ortaket me të drejte vote që zotërojnë me shume se gjysmën e numrit total të kuotave të kapitalit të shoqërisë të cilët votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji 9901 date 14.04.2008 dhe merren vendime të vlefshme me votimin pro të 3/4 të ortakeve pjesëmarrës. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakeve pjesëmarrës, kur në të marrin pjesë ortaket me të drejte vote të cilët zotërojnë me shume se 30 për qind të kuotave për çështje të tjera si :

përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;

emërimin dhe shkarkimin e administratoreve; e

c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar;

përcaktimin shpërblimeve

mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve; Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.



Neni 13

Administrimi

Administratore e shoqërisë është **Elton Jorgjis** i cili do të kryejë veprime në emer dhe për llogari të shoqërisë .

Administratori zgjidhet **për një afat 5 vjet** me të drejtë ripërtëritjeje.

Neni 14

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

Te nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuresë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

Te krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kercenojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

Te raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratoret kanë të drejtë të përfaqësojnë shoqërinë përpara organeve të drejtësisë, gjykatës e prokurorisë , organeve të administratës shtetërore qendrore apo lokale, zyrës së tatimeve etj.

-Administratoret kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm të shoqërisë.

Neni 15

Përgjegjësitë

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas nenëve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçante ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

te ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

te vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

g) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori gjate kryerjes se detyrave to tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet ne mënyrë te arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vlerësimit te informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer ne mirëbesim.

3. Nëse këshilli administrativ vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërbleje shoqërisë dëmet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me to kane realizuar nga këto veprime te parregullta. Administratori ka barrën e provës për te vërtetuar kryerjen e detyrave te tyre ne mënyrë to rregullt e sipas standardeve te kërkuara.

4. Ne mënyrë te veçante, po pa u kufizuar ne to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërbleje shoqërisë dëmet e ,shkaktuara, nëse, ne kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare kryen veprimet e mëposhtme:

- u kthen ortakeve kontributet;
- u paguan ortakeve interesa apo dividendë;
- u shpërndan aktivet shoqërisë;
- lejon qe shoqëria te vazhdoje veprimtarinë tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqëria nuk do te kishte aftësi paguese për te shlyer detyrimet;

jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kane te drejte to ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i është shkaktuar shoqërisë, përfshire edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i asamblesë nuk mund te ndaloje ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit to detyrës.

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon nga data 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor.

Neni 17

Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shpërndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 18

Ekspertet

Eksperti ka për detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabël te veprimtarisë ekonomiko tregtare te shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 19

Te ardhurat e shoqërisë

Te ardhurat neto që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi të ortakeve.

Neni 20

Shpërndarja dhe prishja e shoqërisë

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë;
- me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ". Prishja e shoqërive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatë, për të caktuar një likuidues.

Neni 21

Likuidimi i shoqërisë

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron me shume se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

Neni 22

Baza Ligjore

Shoqëria do të aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit sliqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 23

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 24

Dispozita përfundimtare

Ky statut u redaktua në 4 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua, në parim nën për nën nga Ortaku i vetëm i shoqërisë tregtare " **ALBANET-AL " sh.p.k** , nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

ORTAKU I VETËM

Shoqëria " ALBASCAN" sh.p.k

Përfaqësuar nga Administratori:

Z.Elton JORGJIS

Elton Jorgjis


**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER REZARTA B. KOÇI**

PULLA E TAKSES
U PAGUA



DATE 02/10/2020
NR REP 6325

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 02.10.2020, para meje Notere REZARTA B. KOÇI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.9, BLV"ZOGU I PARE", NR.97, NR.1, NR.1, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Shoqëria "AlbaScan" SHPK, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS L71416010E, me seli në adresë Rruga Barrikada, Hyrja 1, perballe gjimnazit 'Sami Frasheri', Zona kadastrale 8360, Nr pasurie 5/351, **përfaqësuar nga Elton Jorgjis**, atësia Thoma, amësia Vasilika, shtetas Shqiptar, lindur në Sovjan, Korçë dhe banues në KOLONJË, me adresë SEJFI VLLAMASI 02540028; Nd. 7; H. 1; ; ERSEKË; ERSEKË; 7401; KOLONJË, lindur më 07/08/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034465559 dhe nr. personal I00807033U.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Statut i Shoqërisë " ALBANET-AL", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER
REZARTA B. KOÇI**